

MBLEDHJA nr 9

25.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 10438 Prot.

Fier, më 16.08.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Enjte datë 25.09.2025 në orën 13:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **28.08.2025**
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Gusht 2025".

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

4. Projekt – vendim: "Për një ndryshim në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027, të buxhetit dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës dhe institucioneve vartëse të Bashkisë."

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

5. Projekt – vendim: "Për një ndryshim në VKB nr. 138, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier'".

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

6. **Projekt – vendim:** “Për një ndryshim (rishpërndarje fondesh) në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025’, i ndryshuar për efekt të ristrukturimit.”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

7. **Projekt – vendim:** “ Për Miratimin e Projekt Dokumentin të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2026-2028 të Bashkisë Fier”, Faza e II , (i pandyshuar)”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare

8. **Projekt – vendim:** “ Për miratimin e krijimit të Njesisë Shpenzuese dhe ndryshimin e emërimit të disa Njësive Shpenzuese, të Bashkisë Fier

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare

9. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e miratimit për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të pasurisë nr. 86/18 zk. 3031 e llojit “ullishte” me sipërfaqje 187 800 m2, e ndodhur në territorin e Njesisë Administrative Portëz Bashkia Fier, tokë shtetërore me origjinë nga ish – NB Frutore”, pronë në përdorim të Bashkisë Fier”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

10. **Projekt – vendim:** “Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.61, datë 23/06/2025 “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier për shkak të lidhjes së kontratave para noterit” .

11. Projekt – vendim: “Për një saktësim në VKB Nr.64, datë.23/06/2025 të Këshillit të Bashkisë Fier “Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve , që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zgjerimin e sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”.

Komisioni i Ekonomise Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit te Zhvillimit Strategjik te Bashkise, Mbikqyrjes Financiare.

12. Projekt – vendim: ““Për miratimin e implementimit të Projektit Strategjik me titull ‘‘ARIADNE’’, në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III), Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2021–2027.”

Komisioni i Arsimit ,Sporteve, Kultures, Trashegirnise Kulturore, Turizimit , Dhenies se Titujve, Emertimeve, Marredhenjet me jashte dhe Integrimin European.

13. Informacion Këshillit : “Mbi Raportin e Monitorimit për zbatimin e Buxhetit për 4 - mujin e II-të të vitit 2025” të Bashkisë Fier”.

14. Diskutime dhe komente.

**Kryetar Këshilli
Antoneta Cuna**

